

BRANDT Reaction™ K DS

5-0-48-8 p/p

Analizë e Garantuara

Azot Total (N)	5,0% p/p
5,0% p/p Azot Nitrik (N)	
Kalium i Tretshëm në Ujë (K ₂ O)	48,0% p/p
Trioksid squfuri i tretshëm në ujë (SO ₃)	8,0% p/p

Pleh NK (S) 5-48-(8)

PLEH I TRETSHËM NË UJË, I FORMULAR SPECIFIKSHT PËR PJEKJE DHE RRIJJE TË FRUTAVE

Lexoni me kujdes udhëzimet e etiketës së produktit përpara përdorimit. Përdorimi i rezervohet vetëm kultivuesve dhe personelit të autorizuar për aplikim. Për sigurinë humane dhe mjedisore, ndiqni udhëzimet e sigurisë në këtë etiketë. Të ruhet në temperaturë 5°C-35°C. Ky produkt duhet të përdoret vetëm në rastin e kërkesave të shfaqura në kulturat. Mos aplikoni doza më të larta se ato të rekomanduara në etiketë.

Nr. Regj: 3088, datë 18/01/2024

Informacion i Përgjithshëm

BRANDT REACTION K DS është një pleh i tretshëm në ujë që përmban dy lëndë ushqyese kryesore për bimët, Azot dhe Kalium, i projektuar për të rritur përvetësimin e kaliumit.

Teknologjia e patentuar e BRANDT Reaction ofron një përdorim më efikas të lëndëve ushqyese. Teknologjia e tij bazohet në një molekulë, roli i së cilës është të mbrojtë ngarkesën elektrike të kationeve, e cila shmanng lidhjen e lëndëve ushqyese në tokë dhe më pas lejon që më tepër kalium të jetë i disponueshëm për absorbim, si dhe për një kohë më të gjatë. Teknologjia e tij përmirëson lëvizshmërinë dhe disponueshmërinë e kaliumit, duke përmirësuar kështu përdorimin e tij nga bima. Ai gjithashtu lejon një dozë më të vogël të kaliumit sesa plehrat konvencionale.

BRANDT REACTION K DS mund të përdoret si zëvendësues i burimeve tradicionale të kaliumit.

Avantazhet kryesore:

- 100% i tretshëm në ujë
- 100% disponueshmëri të lëndëve ushqyese për bimën
- Thithje të menjëhershme nga bimët
- Kaliumi qëndron më gjatë në tretësirën tokësore
- Shmanng lidhjen e kaliumit nga komplekset argjilo-humike në tokë dhe e ruan kaliumin në tretësirën tokësore
- Rrënjët janë më të afta të konvertojnë më shumë kalium në lëndë ushqyese
- I disponueshëm menjëherë pas aplikimit
- Redukton efektin e kripëzimit në rrënjë dhe nxit rritjen
- Vepron si biostimulant.

Distributor:

PLANTA Sh.P.K

Lgija "18 Tetori", Ruga "Vath Korreshi" nr. 3/1
Lushnje-Albania
Tel & Fax. +355 35 212 004
Email: plantashpk@hotmail.com

Përmbajtja Neto: 5 kg

Pesha Neto: 5 kg



Prodhuar nga:

BRANDT

BRANDT Europe, S.L.
Ctra. Carmona - Guadajoz, Km 3.1
41410 Carmona (Sevilje) Spanje
+34 954 196 230
www.brandt.co

BRANDT REACTION K DS gjithashtu promovon efektin e chelatimit të mikroelementëve bazë si Hekuri, Zinku, Mangani dhe Bakri të cilët ndihmojnë në rritjen e bimëve, përmirësojnë shkallën e fotosintezës dhe efikasitetin e azotit.

BRANDT REACTION K DS përmirëson menjëherë cilësinë, ngjyrën, madhësinë dhe vetitë organoleptike të frutave.

Rekomandime për Kulturat

Ky produkt mund të aplikohet për të gjitha kulturat që nevojiten kalium gjatë ciklit të tyre, si agrume, pemë frutore - farorë e bërthamorë, frutat tropikale, luleshtrydhe, boronicë, mjedër, avokado, perime, ullinjë, bimë zbukuruese, kulturat e arave, hardhi dhe shumë kultura të tjera.

Dozat e Rekomanduara

Megjithatë dozat e aplikimit varen nga niveli i mungesës së kaliumit, normat e mëposhtme rekomandohen nëse nuk keni një analizë tokësore ose gjethore:

Mungesë e lehtë e kaliumit: 2-5 kg/ha

Mungesë e moderuar e kaliumit: 5-10 kg/ha

Mungesë e theksuar e kaliumit: 10-25 kg/ha

BRANDT REACTION K DS mund të aplikohet disa herë gjatë ciklit jetësor të bimëve sipas nevojave të tyre.

Udhëzime për Përzierjen dhe Trajtimin

Ky produkt është projektuar për tu tretur në ujë dhe aplikohet me pajisjet e plehërimit ose i injektuar në sistemet e ujitjes. Hidhni sasinë e rekomanduar të produktit në gjysmën e sasisë së ujit të kërkuar. Shtoni gradualisht ujin e mbetur duke e mbajtur në trazim të vazhdueshëm. Cilësia dhe temperatura e ujit do të përcaktojnë tretshmërinë maksimale. Temperatura më e lartë e ujit rrit tretshmërinë dhe shkurton kohën e tretjes. Ndërsa produkti tretet, temperatura e ujit do të ulet. Prandaj, gjatë përgatitjes së solucioneve të koncentruara, është e rëndësishme të kihet parasysh kjo rënie e temperaturës për tu siguruar që plehrat janë tretur plotësisht.

Përputhshmëria

Ky produkt mund të aplikohet veçmas ose bashkë me shumicën e plehrave të tjerë. Një test përputhshmërie rekomandohet nëse kombinimi i dëshiruar nuk është përdorur më parë. MOS e përdorni këtë produkt me thiosulfat amoni, thiosulfat kaliumi ose produkte të tjera me pH të lartë ose me amoniak të lartë dhe të lirë.

RREZIK

UFI: 5MR0-3041-7008-RKNA

H272: Mund të intensifikojë zjarrin; oksidues.
P102: Mbjani larg fëmijëve.

P210 Mbjani larg nxehtësisë, sipërfaqeve të nxehta, shkëndijave, flakëve të ndezura dhe burimeve të tjera të ndezjes. Ndalohet duhani
P220: Mbjani larg veshmbathjeve dhe materialeve të tjera të djegshme.
P270: Mos hani, pini apo pini duhan kur përdorni këtë produkt.

P280: Vishni doreza/rroba mbrojtëse dhe mbrojtje për sytë/fytyrën.
P370+P378: Në rast zjarri, përdorni mjetet e duhura fikëse të specifikuara nga furnizuesi për shuarje.

P501: Hidhni përmbajtjen/amballazhin në përputhje me rregulloret aktuale për mbetjet e rrezikshme.
EUH401: Për të shmangur rreziqet për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, respektoni udhëzimet e përdorimit.

Magazinimi dhe Trajtimi

Mos ndotni ujr, ushqimin ose ushqimet blegtorale gjatë ruajtjes ose asgjësimit të përmbajtjes së produktit ose paketimit të tij. Mbjani larg fëmijëve. Të ruhet i kycur. Trajtoni përmbajtjen dhe amballazhin në përputhje me rregulloret lokale dhe të Bashkimit Evropian.

GARANCI E KUFIZUAR: Prodhuesi garanton që Produkti përputhet me përshkrimin kimik të dhënë në këtë etiketë dhe është i arsyeshëm dhe i përshatshëm për qëllimin e deklaruar si dhe kur përdoret në përputhje me udhëzimet e etiketës dhe në kushte normale të përdorimit. Prodhuesi dhe Shitësi nuk ofrojnë asnjë garanci tjetër, të shprehur ose të nënkuptuar, përfshirë garancinë e shitjes ose përshatshmërisë për një qëllim të caktuar. Blerësi dhe Përdoruesit pranojnë çdo rrezik që shkaktohet nga çdo përdorim i këtij Produkti. Në masën e lejuar nga ligji, Prodhuesi dhe Shitësi nuk do të jenë përgjegjës ndaj Blerësit ose Përdoruesit të këtij Produkti për ndonjë dëmim pasues, të veçantë, incidental ose indirekt.

Të gjitha markat tregtare të referuara janë në pronësi ose licencim të BRANDT Europe, S.L.

SALBB2403421

Nr. i Serisë:

Data e Prodimit:

AFATI I RUAJTJES: 5 VJET

